

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**40 HADITHE
RRETH
XHENETT**

Tiranë, 2023

Titulli: **40 hadithe rreth Xhenetit**

I përzgjedhi dhe i përktheu: **Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Korrekttoi: **Vjollca Karaj**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie Feza**

Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: Shoqata Flladi – Tiranë, 2023

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar. Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër dhe mbi shokët e tij të zgjedhur!

I Dërguari i Allahut, vula e profetëve, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe Ehli Bejti i tij i pastër (*Paqja qoftë mbi ta!*), na kanë lënë një trashëgimi madhështore, thëniet e tyre të bekuara, të cilat përfshijnë të gjithë jetën e njeriut. Nëse

njeriu interesohet për ato thënie, i lexon, i kupton dhe i zbaton në jetën e tij të përditshme. Si rrjedhim, do të arrijë në përfundimin bindës se këto thënie të begata i sigurojnë atij lumturinë në të dyja jetët.

Profeti Muhamed dhe Ehli Bejti i tij na nxisin që t'i mësojmë përmendësh hadithet e tyre, me qëllim që të bëhen pjesë e kulturës dhe e dukatës sonë dhe me anë të tyre, të afrohemi tek Allahu i Madhëruar. Kjo gjë ka shumë dobi për besimtarin në Jetën Tjetër.

Në një hadith të ardhur nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: “Ai që mëson përmendësh dyzet hadithe, Allahu do ta

ringjallë në Ditën e Kiametit të ditur dhe jurist (fakih)".

Bazuar në këtë vlerë dhe pasuri të trashëguar nga Profeti Muhamed dhe Ehli Bejti, shoqata "Filladi" ka grumbulluar, ka përzgjedhur dhe ka përkthyer në gjuhën shqipe "**40 hadithe rreth Xhenetit**".

Allahu na mbarësoftë të gjithëve në ruajtjen dhe përhapjen e kësaj trashëgimie të vyer e të begatë të Profetit Muhamed dhe të familjes së tij të pastër.

SI TA FITOJMË XHENETIN?

**Me emrin e Allahut, të
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

*Falënderimet i takojnë Allahut të
Madhëruar. Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi
Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër
dhe mbi shokët e tij të zgjedhur!*

Prej qëllimeve të larta të njeriut në
këtë jetë është sigurimi i Xhenetit, në Jetën
Tjetër. Në Xhenet është lumturia e vërtetë.

Allahu i Madhëruar, thotë në Kur'anin e Shenjtë: **“Kurse fatlumët, do të hyjnë në Xhenet, ku do të qëndrojnë përherë, derisa të jenë qiejt dhe Toka, veç si të dojë Zoti yt. Kjo është dhuratë e pandërprerë”**.¹

Në Kur'anin e Shenjtë, Xheneti përmendet 66 herë dhe bashkë me fjalët që formohen prej së njëjtës rrënjë, përmendet 147 herë. Xheneti është vendbanim i përhershëm dhe begatitë e tij janë të pandërprera. Aty do të banojnë punëmirët. Në Xhenet nuk ka as fatkeqësi, as shqetësim e as mërzitje. Banorët e Xhenetit do të kënaqen me mirësitë që Allahu u ka

¹ Sure “Hud”, ajeti 108.

përgatitur, të cilat janë të pashoqe, si nga pamja, ashtu edhe nga shija. Të gjitha fetë e pranojnë ekzistencën e Xhenetit (Parajsës).

Allahu e përshkruan Xhenetin me emra të ndryshëm: *Firdeus, Xhennatu Adnin, Xhennatu Naijm, El Husna, El Gurfetu, Xhennatul Khuld, Xhennatun Alijeh, Darul Akhireh, Darul Karari, Daru Selam, Darul Mutelij, Darul Mukameti.*

Allahu, për çdo gjë, ka vendosur kushte. Edhe për fitimin e Xhenetit ka kushte. Është prej urtësisë dhe drejtësisë së Allahut të Madhëruar që punëmirët t'i shpërblejë në Jetën e Tjetër me Xhenet, në të cilin gjenden mirësi e kënaqësi. Ky është premtim i Allahut, i Cili thotë në Kur'anin e shenjtë: **“Dhe kushdo që bën vepra të**

mira, qoftë ai mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhenet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi".²

Fitimi i Xhenetit është i kushtëzuar. Kushtet e këtij fitimi përmenden në Librin e Shenjtë të Allahut. Në këtë artikull do të paraqesim disa nga kushtet e fitimit të Xhenetit, të përmendura në Fjalën e Allahut Fuqiplotë, Kur'anin e Shenjtë.

Kushti i parë: Besimi dhe puna e mirë

Në shumë ajete, besimi dhe puna e mirë përmenden së bashku. Në Kur'an thuhet: **"Ata që besojnë dhe bëjnë vepra**

² Sure "En Nisa", ajeti 124.

të mira, gëzoji me Xhenetet, nëpër të cilat rrjedhin lumenj...”³

Dhe: “Sa për ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Ne do t’i shpiem në Xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë...”⁴

Dhe: “Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të kenë Xhenetin, si shpërblim për punët (e mira) që kanë bërë.”⁵

Jo vetëm në këto ajete, por edhe në ajete të tjera të Kur’anit, që flasin për këtë tematikë, duket qartë se Xheneti fitohet me besimin se Allahu është Një i Vetëm dhe i

³ Sure “El Bekare”, ajeti 25.

⁴ Sure “En Nisa”, ajeti 57.

⁵ Sure “Es Sexhde”, ajeti 19.

Pashoq dhe Ai është Krijuesi i gjithçkaje. Gjithashtu, Xheneti fitohet me punë të mira, të cilat i pëlqen Allahu i Madhëruar. Është detyra jonë, që të jemi të kujdesshëm në punët dhe në veprat që bëjmë dhe të mos e lejojmë shejtanin e mallkuar, që të na e zbukurojë të keqen dhe të biem pre e mashtrimeve të tij. Të mos jemi si ata, që përmenden në Kur'anin e Shenjtë: **"...Shejtani ua paraqiste të bukura sjelljet e tyre, duke i larguar nga Rruga e Drejtë, prandaj nuk ishin të udhëzuar."**⁶

Nëse duam që kjo jetë të jetë e kënaqshme, e bukur dhe e lumtur, le të besojmë dhe të bëjmë punë të mira. Allahu

⁶ Sure "En Neml", ajeti 24.

thotë: **“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.”⁷**

Dhe: **“Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - pikërisht ata janë krijesat më të mira. Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: Xhenetet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ta, por dhe ata janë të kënaqur me Të. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet.”⁸**

⁷ Sure “En Nahl”, ajeti 97.

⁸ Sure “El Bejjine”, ajetet 7-8.

Dhe: “Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër. Fytyrat e tyre nuk do t’i mbulojë as errësira, as poshtërimi. Ata do të jenë banorë të Xhenetit, në të cilin do të banojnë përherë.”⁹

Besimi, pa punën e mirë, nuk ka asnjë vlerë.

Kushti i dytë: Bindja ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij

Allahu i Madhëruar na urdhëron t’i bindemi Atij dhe të Dërguarit të Tij. Në Kur’an thuhet: “O ju që keni besuar!

⁹ Sure “Junus”, ajeti 26.

Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos ia ktheni shpinën, ndërkohë që e dëgjoni (të vërtetën)!”¹⁰

Bindja ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ka kuptimin e zbatimit të urdhrave dhe të porosive të tyre. Problemet, vuajtjet dhe fatkeqësitë e përhapura sot janë për shkak të mosbindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Bindja ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij është shkak i fitimit të Xhenetit. Këtë e dëshmon edhe Kur’ani i Shenjtë, në të cilin thuhet: “...Atë që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai e shpie në Xhenete, nëpër të cilët rrjedhin

¹⁰ Sure “El Enfal”, ajeti 20.

lumenj dhe ku do të qëndrojë përherë. Kjo është fitorja e madhe.”¹¹

Dhe: “Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.”¹² Sigurisht që fitorja madhështore është Xheneti. Në një ajet tjetër thuhet: “Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të shkojë në Xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, kurse ai që shmanget, do të ndëshkohet me dënim të dhembshëm.”¹³

¹¹ Sure “En Nisa”, ajeti 13.

¹² Sure “El Ahzab”, ajeti 72.

¹³ Sure “El Fet’h”, ajeti 17.

Kushti i tretë: Singëriteti

Singëriteti është prej virtyteve të larta. Ai ka kuptimin, që çdo gjë ta bëjmë për hir të Allahut dhe vetëm për Allahun. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **"...Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!"**¹⁴

Pra, çdo vepër të bëhet me singëritet për hir të Allahut dhe jo për hir të njeriut, sado i lartë të jetë në pozitë, pushtet e dije. Singëriteti është kusht për pranimin e punëve dhe të veprave. Singëriteti është shpirti i adhurimit. Pa singëritetin,

¹⁴ Sure "El Kehf", ajeti 110.

adhurimet nuk asnjë dobi. Allahu i Madhëruar thotë: **“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me sinqeritet, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë.”**¹⁵

Sinqeriteti është shkaku i fitimit të Xhenetit. Allahu i Madhëruar thotë në Kur’anin e shenjtë: **“Kjo është Dita në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre. Atyre u takojnë Xhenetet, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është fitorja e madhe!”**¹⁶

¹⁵ Sure “El Bejjine”, ajeti 5.

¹⁶ Sure “El Maide”, ajeti 119.

Kushti i katërt: Devotshmëria

Ka shumë njerëz, të cilët e kanë të lehtë të bëjnë punë të mira, por e kanë të vështirë t'i ruajnë ato. Kjo, për faktin se, gjatë gjithë jetës së tij, njeriu përballet me dy armiq. Armiku i jashtëm është shejtani, kurse armiku i brendshëm, egoja e tij. Të dy këta armiq përpiqen ta largojnë njeriun nga rruga e Allahut dhe ta çojnë në humbje. Mirëpo, Allahu i Gjithëditur dhe i Gjithëmëshirshëm, e ka pajisur njeriun me një parzmore shumë të fuqishme: me devotshmërinë. Devotshmëria, jo vetëm që e mbron njeriun nga cytjet e shejtanit e të egos, por ajo është shkak i fitimit të Xhenetit.

Të devotshmit do të jenë banorë të Xhenetit. Këtë e dëshmon edhe Kur'ani i Shenjtë: **“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe i Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë, edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi; e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.”**¹⁷

Dhe: **“Sikur ithtarët e Librit të besonin dhe të ishin të devotshëm, Ne do t’ua mbulonim veprat e këqija dhe do t’i shpinim në Xhenetet e kënaqësisë.”**¹⁸

¹⁷ Sure “Ali Imran”, ajetet 133-134.

¹⁸ Sure “El Maide”, ajeti 65.

Dhe: “Vërtet, të devotshmit do të jenë në kopshtet e Xhenetit dhe në lumturi.”¹⁹

Dhe: “Vërtet, për të devotshmit është përgatitur e mira (Xheneti).”²⁰

Dhe: “Dhe jo larg prej aty, Xheneti do t’u afrohet të devotshmëve.”²¹

Ka dhe shumë ajete të tjera që flasin rreth kësaj çështjeje. Devotshmëria të çon në udhëzim dhe në rrugën e shpëtimit në këtë jetë dhe në fitimin e Xhenetit, në Jetën Tjetër.

¹⁹ Sure “Et Tur”, ajeti 17.

²⁰ Sure “En Nebe”, ajeti 31.

²¹ Sure “Kaf”, ajeti 31.

Kushti i pestë: Përmendja e Allahut dhe të menduarit rreth krijimit

Edhe ky është prej shkaqeve të fitimit të Xhenetit. Përmendja e Allahut e mban njeriun gjithmonë pranë Krijuesit të Tij. Kur'ani i Shenjtë na urdhëron që ta përmendim sa më shumë Allahun e Madhëruar: **“O ju që keni besuar! Përmendeni shpesh Allahun dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje!”**²²

Të menduarit rreth krijimit ia shton njeriut më shumë besimin ndaj Allahut Fuqiptotë. Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: **“Për ata që e përmendin Allahun duke**

²² Sure “El Ahzab”, ajetet 41 -42.

qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës, duke thënë: 'O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit. O Zoti Ynë, cilindo që Ti e fut në zjarr, Ti e ke poshtëruar atë. Dhe për mohuesit nuk do të ketë kurrfarë ndihmuesi.

O Zoti Ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonte në besim: 'Besoni Zotin tuaj!' Dhe kështu besuam. O Zoti Ynë! Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të vdesim me të mirët!

O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke premtuar nëpërmjet të Dërguarve të Tu dhe mos na poshtëro në Ditën e Kiametit!

Se Ti, me të vërtetë, nuk e shkel premtimin e dhënë!

Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: ‘Unë nuk do t’ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëlloj (në shpërblim). Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrata e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t’ua mbuloj veprat e këqija dhe do t’i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Shpërblimi më i mirë është tek Allahu.’”²³

Përmendja e Allahut është ilaçi më i mirë për qetësimin e zemrave në këtë jetë. Allahu i Madhëruar thotë në Kur’an:

²³ Sure “Ali Imran”, ajetet 191-195.

“...zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”²⁴

Sigurisht, përmendja e Allahut ka ndikim të madh në jetën e njeriut. Kjo gjë përmendet në treqind ajete të Kur’anit të Shenjtë. Përmendja e Allahut është ibadeti i zemrës, ashtu sikurse namazi është ibadeti i gjymtyrëve. Madje, edhe namazi falet për të përmendur Allahun: **“Fale namazin për të më përmendur Mua!”²⁵**

²⁴ Sure “Er Rra’d”, ajeti 28.

²⁵ Sure “Ta Ha”, ajeti 14.

Kushti i gjashtë: Frika ndaj Allahut

Edhe kjo është një shkak i fitimit të Xhenetit, pasi e bën njeriun të vetëdijshëm se është i mbikëqyrur nga Krijuesi i tij në çdo vepër që bën, në çdo fjalë që thotë, në çdo qëndrim që mban dhe madje, edhe kur mendon. Frika ndaj Allahut përmban dashuri, madhështi, përlulje ndaj Tij. Allahu i Madhëruar thotë: **“Për ata që i frikësohen paraqitjes para Zotit të vet, do të ketë dy Xhenete.”**²⁶

Dhe: **“Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar**

²⁶ Sure “Er Rrahman”, ajeti 46.

veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.”²⁷

Dhe: “Ndërsa ata që i janë frikësuar Zotit të tyre, do të çohen grupe-grupe në Xhenet.”²⁸

Kushti i shtatë: Kërkimi i faljes për gjynahet

Allahu dëshiron që ne të qëndrojmë larg gjynaheve. Ai do që ne të jemi të pastër shpirtërisht. Për të hequr papastërtitë e trupit, ne lahem. Për të hequr papastërtitë e brendshme (shpirtërore), Allahu ka caktuar kërkimin e faljes (istigfarin). Të

²⁷ Sure “En Naziat”, ajetet 40-41.

²⁸ Sure “Ez Zumer”, ajeti 73.

gjithë të Dërguarit e Allahut i urdhëronin popujt e tyre, që t'i kërkonin falje Allahut. **“O populli im! Kërkoni falje nga Zoti juaj dhe kthehuni tek Ai të penduar, se Ai do t’ju sjellë shi të begatshëm dhe do t’ju shtojë fuqi mbi fuqinë tuaj. Mos u shmangni prej Atij duke qenë keqbërës!”**²⁹

Çdo njeri gabon, harron dhe vepron ndonjë vepër të keqe. Të kërkuarit falje Allahut për veprat e këqija, të vogla apo të mëdha, është detyrë e çdo njeriu. Në Kur’anin e shenjtë thuhet: **“Atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe**

²⁹ Sure “Hud”, ajeti 52.

**kërko falje nga Ai. Ai është vërtet Pranues
i madh i pendimeve.”³⁰**

Kërkimi i faljes prej Allahut është shkak i fitimit të Xhenetit, sepse njeriu e lan zemrën e tij me ujin e istigfarit, i cili i largon të gjitha papastërtitë e zemrës. Ndikimi më i mirë i istigfarit duket te braktisja e veprave të këqija. Allahu i Madhëruar thotë në Kur’anin e Shenjtë: **“Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre – e kush i fal gjynahet përveç Allahut? - dhe nuk gulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë. Për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana**

³⁰ Sure “En Nasr”, ajeti 3.

e Zotit të tyre dhe Xhenete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë (vepra të bukura)!”³¹

Dhe: “Prandaj rrekuni me njëritjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe Xhenetin e gjerë sa qielli dhe Toka, që është e përgatitur për ata që i kanë besuar Allahut dhe të Dërguarve të Tij. Ajo është mirësia e Allahut, që Ai ia jep kujt të dojë; e Allahu ka mirësi të pafund.”³²

³¹ Sure “Ali Imran”, ajetet 135-136.

³² Sure “El Hadijd”, ajeti 21.

Kushti i tetë: Urdhërimi për të bërë vepra të mira, të ndaluarit nga e keqja, falja e namazit dhe dhënia e zekatit

Këtë e dëshmon thënia e Allahut të Madhëruar: “Besimtarët dhe besimtare të tjerët janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t’i mëshirojë Allahu. Se, Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë. Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve Xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë, si dhe pallate të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Por kënaqësia prej

Allahut është shpërblimi më i madh. Kjo është fitorja madhështore”.³³ Këto veti duhet të gjenden te çdo besimtar, me qëllim që të fitojë Xhenetin.

Dhe: “...Unë jam me ju! Në qoftë se do të kryeni namazin, do të jepni zekatin, do të besoni të Dërguarit e Mi, do t’i ndihmoni ata dhe do t’i jepni vullnetarisht hua Allahut, atëherë, patjetër që Unë do t’jua shlyej gjynahet dhe do t’ju shpie në Xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Por, kushdo nga ju që mohon pas kësaj, me të vërtetë, e ka humbur Rrugën e Drejtë.”³⁴

³³ Sure “Et Teube”, ajetet 71-72.

³⁴ Sure “El Maide”, ajeti 12.

Kushti i nëntë: Emigrimi dhe xihadi në Rrugën e Allahut, me pasuri e me shpirt

Emigrimi dhe xihadi në rrugën e Allahut janë prej veprave të pëlqyera në Islam. Besimtari i vërtetë i kryen këto, për hir të Allahut dhe për të fituar kënaqësinë e Tij. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ata që besojnë, mërgojnë dhe luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë e tyre dhe jetën e tyre, janë në shkallë më të lartë tek Allahu. Pikërisht këta janë të fituarit. Zoti i tyre u jep lajmin e mirë për mëshirën dhe miratimin e Tij, si dhe për Xhenetet ku do të ketë kënaqësi të përhershme për ta dhe ku do të qëndrojnë përgjithmonë.**

Me të vërtetë, vetëm tek Allahu është shpërblimi i madh.”³⁵

Dhe: “Por, i Dërguari dhe ata që besojnë në të, luftojnë me pasurinë e tyre dhe jetën e tyre. Për ata do të ketë çdo të mirë dhe pikërisht ata do të jenë të shpëtuarit. Allahu u ka përgatitur atyre kopshtet e Xhenetit, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore.”³⁶

Dhe: “Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky

³⁵ Sure “Et Teube”, ajetet 20-22.

³⁶ Sure “Et Teube”, ajetet 88-89.

është) premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kur'an. E kush i përmbahet besëlidhjes më fort se Allahu? Prandaj, gëzojuni kësaj shitjeje! Kjo është fitorja madhështore."³⁷

Dhe: "Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata Xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!"³⁸

³⁷ Sure "Et Teube", ajeti 111.

³⁸ Sure "Et Teube", ajeti 100.

Nga ajetet e përmendura, sqarohet se këto dy vepra janë shkak për fitimin e Xhenetit. Mirëpo, duhet të bëhet dallimi mes xhihadit të vërtetë dhe atij pretendues. Nëse nuk do të bëhet dallimi, atëherë xhihadi do të jetë shkatërrues dhe njollë e zezë për Islamin dhe për myslimanët. Nuk mund të quhet xhihad vrasja e të pafajshmëve, vjedhja dhe grabitja e pasurisë së tjetrit me pa të drejtë. As Xhehenemi nuk do t'i pranojë ata që vrasin padrejtësisht të tjerët. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "**...kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë**

**çrregullime në Tokë, është sikur të ketë
vrrarë të gjithë njerëzit.”³⁹**

***Kushti i dhjetë: Qëndrueshmëria në rrugën
e Allahut (Istikame)***

Kuptimi i saj është ecja në Rrugën e Drejtë. Është kapja pas fesë, zbatimi i dispozitave të saj dhe përhapja e saj në mesin e njerëzve. Allahu thotë në Kur’an: **“Prandaj qëndro i patundur në Udhën e Drejtë, ashtu siç je i urdhëruar! Ashtu le të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty,**

³⁹ Sure “El Maide”, ajeti 32.

e mos i kaloni kufijtë, se Ai, me të vërtetë, i sheh mirë ato që punoni ju.”⁴⁰

Në ajet duket qartë urdhri i Allahut për istikamet, për të gjithë besimtarët. Kushdo që është i palëkundur në fenë e tij, do të jetë prej banorëve të Xhenetit. Në Kur’anin e Shenjtë thuhet: **“Me të vërtetë, atyre që thonë: ‘Zoti ynë është Allahu’, e pastaj vazhdojnë të palëkundur në Rrugën e Drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: ‘Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar!’”⁴¹**

⁴⁰ Sure “Hud”, ajeti 112.

⁴¹ Sure “El Fusilet”, ajeti 30.

Dhe: **“Pa dyshim, ata që thonë: ‘Zoti ynë është Allahu!’ dhe pastaj qëndrojnë në Rrugën e Drejtë, nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar e as për t’u dëshpëruar (kur t’u vijë vdekja). Ata do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë, si shpërblim për atë që kanë punuar.”⁴²**

Në fenë e pastër islame, shkaqet për fitimin e Xhenetit janë të shumta, si: morali i mirë, kujdesi ndaj jetimit, mirësjellja ndaj prindërve, ndërtimi i xhamive, agjërimi, Haxhi etj.

Allahu na bëftë prej banorëve të Xhenetit!

⁴² Sure “El Ahkaf”, ajetet 13-14.

**40 HADITHE
RRETH
XHENETT**

Hadithi 1

Malli për Xhenetin

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
"Ai që ka mall për Xhenetin, shpejton në bërjen e të mirave."⁴³

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): "من اشتاق إلى الجنة سارع في الخيرات."
(البحار : 77 / 94 / 1)

⁴³ "Biharul Enuar", vëll. 77, Hadithi 1, f. 94.

Hadithi 2

Hapësira e Xhenetit

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Nëse me patjetër jeni prej dëshiruesve, atëherë
dëshirojeni Xhenetin, hapësira e të cilit është sa
qiejt e Toka."⁴⁴

قال الإمام علي (عليه السلام):
"إن كنتم راغبين لا محالة فارغبوا في جنة عرضها السماوات والأرض."
(غرر الحكم : 3736)

⁴⁴ "Gurerul Hikem", Hadithi 3736.

Hadithi 3

Madhështia e mirësisë së Xhenetit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Unë kam përgatitur për robtë e Mi punëmirë atë që sytë nuk e kanë parë, as veshët nuk e kanë dëgjuar e as në zemrën e ndonjë njeriu nuk është përjetuar.”⁴⁵

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

“قال الله تعالى: أعددت لعبادي الصالحين ما لا عين رأت، ولا اذن سمعت، ولا خطر على قلب بشر.” (كنز العمال: 43069، البحار: 168/191 / 8 مع تفاوت يسير في اللفظ).

⁴⁵ “Kenzul Ummal” 43069; “Biharul Enuar”, vëll. 8, Hadithi 168, f. 191 me ndryshim të vogël në shprehje.

Hadithi 4

Çfarë duhet të bëjë dëshiruesi i Xhenetit?

Imam Zejnul Abidini (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Dijeni, se ai që ka mall për Xhenetin, shpejton në bërjen e veprave të mira dhe largohet nga epshet. Ai që i frikësohet zjarrit, nxiton në pendimin te Allahu për gjynahet e tij dhe heq dorë nga të ndaluarat.”*⁴⁶

قال الإمام زين العابدين (عليه السلام):
“اعلموا أنه من اشتاق إلى الجنة سارع إلى الحسنات، وسلا عن الشهوات، ومن
أشفق من النار بادر بالتوبة إلى الله من ذنوبه، وراجع عن المحارم.”
(تحف العقول : 281 .)

⁴⁶ “Tuḥful Ukulī”, Hadithi 281.

Hadithi 5

Çmimi i Xhenetit

Imam Sadiku (*Paqja goftë mbi të!*) ka thënë:
"Thënia: 'Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut! (La ilhahe il'laAll'illah)', është çmimi i Xhenetit."⁴⁷

قال الإمام الصادق (عليه السلام): "قول لا إله إلا الله ثمن الجنة."
(التوحيد : 21 / 13).

⁴⁷ "Et-Teuhjd", Hadithi 21, f. 13.

Hadithi 6

Teuhidi të çon në Xhenet

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *"Kush vdes dhe e di që Allahu është e vërteta (i Vërteti), ai hyn në Xhenet."*⁴⁸

قال الإمام علي (عليه السلام):
"إنه ليس لأنفسكم ثمن إلا الجنة ، فلا تتبعوها إلا بها."
(البحار : 78 / 13 / 71).

⁴⁸ "El-Biharu", vëll. 78, Hadithi 71, f. 13

Hadithi 7

Mos e shisni Xhenetin!

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Për ju nuk ka çmim tjetër veçse Xheneti,
prandaj mos e shisni atë për gjë tjetër."⁴⁹

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
"من مات وهو يعلم أن الله حق دخل الجنة."
(التوحيد : 29 / 30)

⁴⁹ "Et Teuhijd", vëll. 29, f. 39.

Hadithi 8

Rrugua për të hyrë në Xhenet

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ka thënë Ebu Dherrit: “A dëshiron të hysh në Xhenet?”

- Po, babai im u bëftë kurban për ty! – iu përgjigj Ebu Dherri.
- Atëherë pakësoje shpresën, vendose vdekjen para syve të tu dhe ki turp nga Allahu, - i tha i Dërguari i Allahut.⁵⁰

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله) لأبي ذر:
”أتحب أن تدخل الجنة؟ قال: قلت: نعم فذاك أي، قال: فاقصر من الأمل، و
جعل الموت نصب عينك، واستح من الله حق الحياء.”
أمالي الطوسي: 534

⁵⁰ “Amalij” i Et Tusij, Hadithi 534.

Hadithi 9

Sa kushton hyrja për në Xhenet?

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*"Hyrja për në Xhenet është e lirë, kurse hyrja
për në zjarr është e shtrenjtë."*⁵¹

قال الإمام علي (عليه السلام): "دخول الجنة رخيص ، ودخول النار غال."
(البحار : 78 / 90 / 95).

⁵¹ "El Biharu", vëll. 78, Hadithi 95, f. 90.

Hadithi 10

Çfarë të çon në Xhenet?

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Ato që e fusin umetin tim në Xhenet, janë: devotshmëria ndaj Allahut dhe morali i mirë."⁵²

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
"أكثر ما تلج به أمتي الجنة : تقوى الله وحسن الخلق."
(الكافي : 2 / 100 / 6)

⁵² "El Kafi", vëll. 2, Hadithi 6, f. 100.

Hadithi 11

Xheneti, vendbanimi i të devotshmëve

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Dyngjaja është vendbanimi i të ligjve. Xheneti është vendbanimi i të devotshmëve.”*⁵³

قال الإمام علي (عليه السلام): "الدنيا دار الأشقياء ، الجنة دار الأنقياء"
(غرر الحكم: 437 – 438)

⁵³ “Gurerul Hikemi”, Hadithet 437-438.

Hadithi 12

Katër virtyte të çojnë më Xhenet

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Kush ka një prej këtyre katër cilësive, hyn në Xhenet: ai që strehon jetimin, mëshiron të dobëtin, ka dhembshuri për prindërit e tij dhe është i butë me shërbëtorin e tij."⁵⁴

قال الإمام الباقر (عليه السلام):
"أربع من كن فيه بنى الله له بيتا في الجنة: من آوى اليتيم، ورحم الضعيف، وأشفق
على والديه، ورفق بمملوكه."
(ثواب الأعمال : 1 / 161)

⁵⁴ "Theuabul A'mali", vëll. 161, f. 1.

Hadithi 13

Synimi më i mirë

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Xheneti është synimi më i mirë.”⁵⁵

قال الإمام علي (عليه السلام): "الجنة أفضل غاية." (غرر الحكم : 1024)

⁵⁵ “Gurerul Hikemi”, Hadithi 1024.

Hadithi 14

Të tallurit me vetveten

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Kushdo që i kërkon Allahut Xhenetin dhe nuk
duron vështirësitë, është tallur me veten e tij."⁵⁶

قال الإمام الرضا (عليه السلام):
"من سأل الله الجنة ولم يصبر على الشدائد فقد استهزأ بنفسه."
(البحار: 78 / 356 / 11)

⁵⁶ "El Bihar", vëll. 78, Hadithi 356, f. 11.

Hadithi 15

Një pëllëmbë vend në Xhenet është më e mirë se gjithë dynjaja

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Një pëllëmbë vend në Xhenet është më e mirë se dynjaja dhe çfarë ka në të."⁵⁷

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): "شِبْرٌ مِنَ الْجَنَّةِ خَيْرٌ مِنَ الدُّنْيَا وَمَا فِيهَا."
(جامع الأخبار، ص 174)

⁵⁷ "Xhamiul Akhbari", f. 174.

Hadithi 16

Cilësitë e Xhenetit

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Kënaqësia që ndien, kur je në Xhenet, është e
papërshkrueshme dhe banorët e tij
(xhenetlinjtë) nuk ndahen. Ata janë fqinjët e të
Gjithëmëshirshmit (Allahut)."⁵⁸

قال الإمام علي (عليه السلام):
"لَأَتَانِهَا لَا تُعِيلُ وَ مُجْتَمِعُهَا لَا يَتَفَرَّقُ، سُكَّانُهَا قَدْ جَاوَزُوا الرَّحْمَانَ."
(الامالی للمفید، ص 266).

⁵⁸ "El Amalij "i Mufijdit, f. 266.

Hadithi 17

Xheneti dhe vështirësitë

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Xheneti është i rrethuar me vështirësi dhe durim. Kush duron ndaj vështirësive në dynja, hyn në Xhenet. Xhehenemi është i rrethuar me kënaqësi e epshe. Kush jepet pas kënaqësive dhe epsheve, hyn në zjarr.”⁵⁹

قال الإمام الباقر (عليه السلام):
“الْجَنَّةُ مَحْفُوفَةٌ بِالْمَكَارِهِ وَالصَّبْرُ، فَمَنْ صَبَرَ عَلَى الْمَكَارِهِ فِي الدُّنْيَا دَخَلَ الْجَنَّةَ. وَ
جَهَنَّمَ مَحْفُوفَةٌ بِاللَّذَائِقِ الشَّهَوَاتِ، فَمَنْ أَعْطَى نَفْسَهُ لَذَّتَهَا وَشَهْوَتَهَا دَخَلَ النَّارَ.”
(الكافي، ج 2، ص 89).

⁵⁹ “El Kafi”, vëll. 2, Hadithi 1, f. 89.

Hadithi 18

Porta e agjëruesve në Xhenet

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Në Xhenet gjendet një portë, që quhet Rejan. Në atë portë nuk hyn askush tjetër përveç agjëruesve.”⁶⁰

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
”إِنَّ لِلْجَنَّةِ بَابًا يُدْعَى «الرَّيَّانُ» لَا يَدْخُلُ مِنْهُ إِلَّا الصَّائِمُونَ.”
(معاني الاخبار، ص 409)

⁶⁰ “Meanij El Akhbar”, f, 409.

Hadithi 19

Ruajtja e gjuhës dhe e nderit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Kush ruan gjuhën dhe organet e tij, unë do t'i garantoj atij Xhenetin."⁶¹

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
"مَنْ صَمِنَ لِي مَا بَيْنَ لِحْيَتَيْهِ وَ مَا بَيْنَ رِجْلَيْهِ صَمِنْتُ لَهُ عَلَى اللَّهِ الْجَنَّةَ."
(وسائل الشيعة، ج 15، ص 250)

⁶¹ "Uesailu Shia", vëll. 15, f. 250.

Hadithi 20

Shkallët e Xhenetit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Në Xhenet ka shkallë, të cilat nuk i ngjit veçse imami i drejtë, ai që mban lidhjet familjare dhe ai që ka fëmijë shumë dhe është durimtar.”⁶²

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
”إِنَّ فِي الْجَنَّةِ دَرَجَةً لَا يَبَالُغُهَا إِلَّا إِمَامٌ عَادِلٌ، أَوْ ذُو رَحِمٍ وَصُولٍ، أَوْ ذُو عِيَالٍ صَبُورٍ.
(الخصال، ج 1، ص 93)”

⁶² “El Khisal”, vëll. 1, f. 93.

Hadithi 21

Fituesi i Xhenetit

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Nuk e fiton Xhenetin veçse ai që e ka të
brendshmen e tij të pastër dhe nijetin të
sinqertë."⁶³

قال الإمام علي (عليه السلام):
"لَا يَفُوزُ بِالْجَنَّةِ إِلَّا مَنْ حَسَّنَتْ سَرِيرَتَهُ وَ خَلَصَتْ نِيَّتُهُ."
(غرر الحكم، ص 168 رقم 3325)

⁶³ "Gurerul Hikemi", Hadithi 3325, f. 168.

Hadithi 22

Shtëpitë e Jetës Tjetër

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Çdokush, në Jetën Tjetër (*Ahiret*), do të ketë dy shtëpi: një në Xhenet e tjetrën në Xhehenem.”⁶⁴

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
"لَيْسَ مِنْكُمْ أَحَدٌ إِلَّا وَ لَهُ مَنْزِلَانِ: أَحَدُهُمَا فِي الْجَنَّةِ وَ الْآخَرُ فِي النَّارِ."
(كنز العمال، ج 14، ص 496)

⁶⁴ "Kenzul Ummal", vëll. 14, . 496.

Hadithi 23

Melodia e Xhenetit

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Në Xhenet ndodhen pemë dhe Allahu e urdhëron erën e Xhenetit të fryjë dhe t’i godasë ato pemë, të cilat lëshojnë melodi të këndshme. Njerëzit nuk kanë dëgjuar kurrë melodi të tillë. Kjo melodi është kompensim për ata që, nga frika ndaj Allahut, qëndruan larg dëgjimit të muzikës degjeneruese.”⁶⁵

قال الإمام الصادق (عليه السلام):
“إِنَّ فِي الْجَنَّةِ شَجَرًا يَأْمُرُ اللَّهُ رِياحَهَا فَتَهْبُ فْتَضْرِبُ تِلْكَ الشَّجَرَةَ بِأَصْوَاتٍ لَمْ يَسْمَعْ
الْخَلَائِقُ بِمِثْلِهَا حَسَنًا، ثُمَّ قَالَ: هَذَا عَوَظٌ لِمَنْ تَرَكَ السَّعَاةَ فِي الدُّنْيَا مِنْ مَخَافَةِ
اللَّهِ.” (بحار الانوار، ج 8، ص 126)

⁶⁵ “Biharul Enuar”, vëll. 8, f. 126.

Hadithi 24

Pema e Xhenetit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
"Te dera e Xhenetit ndodhet një pemë. Nën një gjethe të saj hijezohen një mijë persona."⁶⁶

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
"عَلَى بَابِ الْجَنَّةِ شَجَرَةٌ إِنَّ الْوَرْقَةَ مِنْهَا لَيَسْتَضِلُّ تَحْتَهَا أَلْفٌ رَجُلٍ مِنَ النَّاسِ."
(الكافي، ج 8، ص 95).

⁶⁶ "El Kafi", vëll. 8, f. 95.

Hadithi 25

Të parët që hyjnë në Xhenet

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Të parët që hyjnë në Xhenet, janë tre: dëshmori në rrugën e Allahut; robi, të cilin robëria e tij nuk e pengon t’i bindet Allahut dhe i varfëri që, edhe pse me shumë fëmijë, jeton me pastërri e ndershmëri.”⁶⁷

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
"ثَلَاثَةٌ أَوَّلُ مَنْ يَدْخُلُ الْجَنَّةَ: الشَّهِيدُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ، وَ الْمَمْلُوكُ لَمْ يَشْغَلْهُ رِقُّهُ عَنْ طَاعَةِ رَبِّهِ وَ فَقِيرٌ ذُو عِيَالٍ مُتَعَفِّفٌ." (ميزان الحكمه، حديث 2636)

⁶⁷ "Mijzanul Hikmeti", Hadithi 2636.

Hadithi 26

Shkaku i përjetësisë në Xhenet dhe në Xhehenem

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Banorët e zjarrit do të qëndrojnë përgjithmonë në Xhehenem, sepse qëllimet e tyre në këtë jetë (dynja), gjithmonë e kanë kundërshtuar Allahun. Kështu që nijetet janë ato që u përcaktojnë vendin banorëve të Botës Tjetër, nëse do të qëndrojnë përjetësisht në Xhenet apo në Xhehenem.”*⁶⁸

قال الإمام الصادق (عليه السلام):
“إِنَّمَا خُلِدَ أَهْلُ النَّارِ فِي النَّارِ لِأَنَّ نِيَّاتِهِمْ كَانَتْ فِي الدُّنْيَا أَنْ لَوْ خَلَدُوا فِيهَا، أَنْ يَعْصُوا اللَّهَ أَبَدًا، وَإِنَّمَا خُلِدَ أَهْلُ الْجَنَّةِ فِي الْجَنَّةِ لِأَنَّ نِيَّاتِهِمْ كَانَتْ فِي الدُّنْيَا أَنْ لَوْ بَقُوا فِيهَا أَنْ يُطِيعُوا اللَّهَ أَبَدًا، فَبِالنِّيَّاتِ خُلِدَ هَؤُلَاءِ وَ هَؤُلَاءِ.” (الكافي، ج 2، ص 85)

⁶⁸ “El Kafi”, vëll. 2, f. 85.

Hadithi 27

Shitja e vetes

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*Ai që e shet veten për diçka tjetër, përveç begatisë së Xhenetit, i ka bërë padrejtësi vetes.*”⁶⁹

قال الإمام علي (عليه السلام): "من باع نفسه بغير نعيم الجنة فقد ظلمها."
(غرر الحكم : 9164)

⁶⁹ "Gurerul Hikemi", Hadithi 9164.

Hadithi 28

E mira e Zjarrit dhe e mira e Xhenetit

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
"Nuk është e mirë ajo e mirë, pas së cilës ka
Zjarr; nuk është e keqe ajo e keqe, pas së cilës ka
Xhenet. Çdo mirësi, përveç mirësisë së
Xhenetit, është e shpifur dhe çdo fatkeqësi tjetër,
përveç Zjarrit, është shëndet."⁷⁰

قال الإمام علي (عليه السلام):
"ما خير بخير بعده النار، وما شر بشر بعده الجنة، وكل نعيم دون الجنة فهو
محقور، وكل بلاء دون النار عافية." (نهج البلاغة : الحكمة : 387).

70 "Nehxhul Belaga", Urtësia 387.

Hadithi 29

Xheneti i ndalohet tre personave

Imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "*Xheneti është i ndaluar për tre (persona): thashethemexhiun, alkoolistin dhe qyqarin që është imoral.*"⁷¹

قال الإمام الكاظم عليه السلام:

"حرمت الجنة على ثلاثة: النام، ومدمن الخمر، والديوث وهو الفاجر."

(ثواب الأعمال : 262 / 3)

⁷¹ "Theuabul A'mali", Hadithi 262, f. 3.

Hadithi 30

Dashuria për familjen e Profetit të çon në Xhenet

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush vdes me dashurinë për familjen e Muhamedit, ai përcillet për në Xhenet ashtu siç përcillet nusja në shtëpinë e burrit të saj. Kush vdes me dashurinë për familjen e Muhamedit, në varrin e tij do të hapen dy dyer për në Xhenet.”⁷²

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

“...ألا ومن مات على حب آل محمد يزف إلى الجنة كما تزف العروس إلى بيت زوجها ألا ومن مات على حب آل محمد صلى الله عليه وآله فتح له في قبره بابان إلى الجنة...” (تفسير الكشاف للزمخشري ج. ٤ تفسير الآية ٢٣ من سورة الشورى)

⁷² “El Keshshaf”, vëll. 4, Komentimi i ajetit 23 i sures “Esh Shura”.

Hadithi 31

Lumi Rexheb

Ebu Hasani, Imam Musa ibn Xha'ferri (Paqja qoftë mbi të!) kanë thënë: *“Rexhebi është një lumë në Xhenet. Ai është më i bardhë se qumështi dhe më i ëmbël se mjalti. Kush agjëron një ditë në Rexheb, Allahu do t'i japë të pijë nga ky lumë.”*⁷³

قَالَ أَبُو الْحَسَنِ مُوسَى بْنُ جَعْفَرٍ (عَلَيْهِ السَّلَامُ):
"رَجَبٌ نَهْرٌ فِي الْجَنَّةِ، أَشَدُّ بَيَاضاً مِنَ اللَّبَنِ وَ أْحْلَى مِنَ الْعَسَلِ، فَمَنْ صَامَ يَوْمًا
وَنَزَجَ سَقَاهُ اللَّهُ مِنْ ذَلِكَ النَّهْرِ" (من لا يحضره الفقيه: 2 / 92)

⁷³ "Men la jehdheruhul fakijh", Hadithi 2, f. 92.

Hadithi 32

Mendjemadhësia është pengesë për Xhenetin

Ebu Xha'ferri (Imam Bakiri) dhe Ebu Abdullahu (Imam Sadiku) (*Paqja qoftë mbi ta!*) kanë thënë: *"Nuk hyn në Xhenet ai që në zemrën e tij ka një grimcë mendjemadhësie."*⁷⁴

عن أبي جعفر وأبي عبد الله عليهما السلام قالوا:
"لا يدخل الجنة من في قلبه مثقال ذرة من كبر." (الكافي ج ٢ ص ٣١٠)

⁷⁴ "El Kafi", vëll. 2, f. 310.

Hadithi 33

Kush banon në dhomat e Xhenetit?

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Në Xhenet ka dhoma, ku e jashtëmja e tyre duket nga e brendshmeja e tyre dhe anasjelltas, e brendshmeja e tyre duket nga e jashtëmja e tyre. Në to banojnë ata që flasin fjalë të mira, japin ushqim (ushqejnë të varfrit), përhapin selamin, falen natën kur njerëzit janë në gjumë.”*⁷⁵

33- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): "إِنَّ فِي الْجَنَّةِ غُرَفًا يُرَى ظَاهِرُهَا مِنْ بَاطِنِهَا وَبَاطِنُهَا مِنْ ظَاهِرِهَا أَعَدَّهَا اللَّهُ لِمَنْ أَطْعَمَ الطَّعَامَ وَأَفْشَى السَّلَامَ وَصَلَّى بِاللَّيْلِ وَالنَّاسُ نِيَامٌ." (بخار الانوار، ج 8، ص 119)

⁷⁵ "Biharul Enuar", vëll. 8, f. 119.

Hadithi 34

Shkallët e Xhenetit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Xheneti ka njëqind shkallë. Largësia mes dy shkallëve është si largësia mes qiellit dhe tokës. Firdeusi është shkalla më e lartë. Nga ai shpërthejnë katër lumenj. Kur t’i kërkonti Allahut, kërkojini Firdeusin.”⁷⁶

عن رسول الله (صلى الله عليه وآله) قال:
"الجنة مائة درجة ما بين كل درجتين كما بين السماء والأرض، الفردوس أعلاها درج
ة منها تفجر أنهار الجنة الأربعة، فإذا سألت الله فاسأله الفردوس."
(بحار الأنوار ج 8 ص ٨٩)

⁷⁶ "Biharul Enuar", vëll. 8, f. 89.

Hadithi 35

Xheneti dhe lufta me vetveten

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Xhenetin do ta arrijë vetëm ai që lufton me
veten e tij."⁷⁷

قال الإمام علي (عليه السلام): "لن يجوز الجنة إلا من جاهد نفسه."
(غرر الحكم: 7421)

⁷⁷ "Guretul Hikemi", Hadithi 7421.

Hadithi 36

Vepra e Xhenetit dhe vepra e Zjarrit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Vërtet, vepra e Xhenetit është e vështirë e me ngritje, kurse vepra e zjarrit është e lehtë e me epsh."⁷⁸

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

"ألا وإن عمل الجنة حزن بربوة ، ألا وإن عمل النار سهل بشهوة."

(كنز العمال : 43605 : 44159)

⁷⁸ "Kenzul Ummal", Hadithi 44159, f. 43605.

Hadithi 37

Vendbanimi i gëzimit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Në Xhenet ndodhet një vendbanim që quhet Vendbanimi i gëzimit. Në të nuk hyn askush, përveç atij që gëzon jetimët e besimtarëve.”⁷⁹

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
"لَنْ فِي الْجَنَّةِ دَارًا يُقَالُ لَهَا دَارُ الْفَرْحِ لَا يَدْخُلُهَا إِلَّا مَنْ فَرَّحَ بِتَأْمِي الْمُؤْمِنِينَ."
(نهج الفصاحة ص 329 ، ح 864)

⁷⁹ "Nehxhul Fasahah", Hadithi 864, f. 328.

Hadithi 38

Shenjat e xhenetlinjve

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Për banorët e Xhenetit ka katër shenja: fytyrë
të gëzuar, gjuhë të butë, zemër të mëshirshme
dhe dorë dhuruese.”⁸⁰

قال الإمام الصادق (عليه السلام):
“إِنَّ لِأَهْلِ الْجَنَّةِ أَرْبَعَ عِلَامَاتٍ وَجْهٌ مُنْبَسِطٌ وَ لِسَانٌ لَطِيفٌ وَ قَلْبٌ رَجِيمٌ وَ يَدٌ مُع
طِيَّةٌ.” (امالی (طوسی) ص 683 ، ح 1454)

⁸⁰ “Amaliy” i Tusit, Hadithi 1454, f. 683.

Hadithi 39

Shkujdesja ndaj Xhenetit dhe Xhehenemit

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Unë kurrë nuk kam parë diçka të ngjashme me
Xhenetin, që kërkuesi (fituesi) i tij (Xhenetit) të
jetë në gjumë. Kurrë nuk kam parë diçka si
zjarri i Xhehenemit, që ikësi prej tij të jetë në
gjumë të thellë.”⁸¹

قال الإمام علي (عليه السلام):
“ألا وإني لم أر كالجنة نام طالها ولا كالنار نام هارها.”
(نهج البلاغة : الخطبة 28)

⁸¹ “Nehxhul Belaga”, Hytbeja 28.

Hadithi 40

Xheneti arrihet me punë

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Xheneti nuk arrihet duke shpresuar."⁸²

قال الإمام علي (عليه السلام): "لا تحصل الجنة بالتمني." (غرر الحكم : 10566)

⁸² "Gurerul Hikemi", Hadithi 10566.

اسم الكتاب: اربعون حديث عن الجنة

ترجمة الأحاديث: الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحيح الادبي: بيريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الإخراج النهائي: صبريه فزا

الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعيت نسيم

تيرانا: 2023